



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1951/ 10 prot.

Datë 10.10.2025

V E N D I M

Nr. 1430/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.10.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1333/2025, datë 25.09.2025, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-49399-05-28-2025, me objekt “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Rikonstruksion objekti ekzistues i pallatit të sportit “Tamara Nikolla”, Korçë” me fond limit: 249,999,211.89 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 16.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK, me NIPT K66613407H, dhe adresë: Bulqize Diber Bulqize, ,Lagjja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15.

Autoriteti Kontraktor: Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për

Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 25.09.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1333/2025, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-49399-05-28-2025, me objekt “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Rikonstruksion objekti ekzistues i pallatit të sportit “Tamara Nikolla”, Korçë” me fond limit: 249,999,211.89 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 16.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë, OE “Lis Konstruksion” SHPK, referuar konstatimeve në këtë vendim.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 3377/2 prot., datë 06.10.2025, protokolluar me tonën nr. 1951/7 prot., datë 07.10.2025, autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1333/2025, datë 25.09.2025, si vijon: “.....Në zbatim të vendimit nr.1333/2025 datë 25.09.2025, gjeni bashkëlidhur rivlerësimin në SPE të operatorit ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit, me objekt “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Rikonstruksion objekti ekzistues i pallatit të sportit “Tamara Nikolla”, Korçë”, si dhe gjithë dokumentacionin mbi bazën e të cilit është kryer verifikimi në zbatim të Vendimit të KPP. Bashkëlidhur informacionit:

-Tabela e përlllogaritjes së volumeve specifike për kontratat e marra në shqyrtim;

-Komunikimi me Bashkinë Durrës dhe Bashkinë Gjirokastrë, dërguar dokumentacioni teknik (leje ndërtimi, projekt zbatimi për secilen kontratë publike).

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 3377/2 prot., datë 06.10.2025, protokolluar me tonën nr. 1951/7 prot., datë 07.10.2025, autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 1333/2025, datë 25.09.2025, si vijon: “.....Në zbatim të vendimit nr.1333/2025 datë 25.09.2025, gjeni bashkëlidhur rivlerësimin në SPE të operatorit ekonomik “Lis Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit, me objekt “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Rikonstruksion objekti

ekzistues i pallatit të sportit "Tamara Nikolla", Korçë", si dhe gjithë dokumentacionin mbi bazën e të cilit është kryer verifikimi në zbatim të Vendimit të KPP. Bashkëlidhur informacionit:

-Tabela e përlllogaritjes së volumeve specifike për kontratat e marra në shqyrtim;

-Komunikimi me Bashkinë Durrës dhe Bashknë Gjirrokastër, dërguar dokumentacioni teknik (leje ndërtimi, projekt zbatimi për secilen kontratë publike).

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, dhe informacionit analitik dhe teknik të dërguar nga autoriteti kontraktor. Konkretisht, në zbatim të vendimit të KPP 1333/2025, datë 25.09.2025, ku autoriteti kontraktor ka kryer hetimet shteruese në lidhje me evidentimit/saktësimin të sipërfaqeve të ndërtimit të objekteve, për kontratat e marra në vlerësim/shqyrtim, duke argumentuar analitikisht në trajtë tabelare dhe shoqëruar me dokumentacionin teknik si Miratim kërkesë për leje ndërtimi, Leje Ndërtimi dhe projekt zbatimi të mirataura nga Bashkia e Durrësit dhe Bashkia e Gjirrokastër, mbi kontratat publike të realizuara nga operatori ekonomik "Lis Konstruksion" SHPK. Në përfundim të hetimit të kryer nga autoriteti kontraktor, ky i fundit ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik dhe ka ri-vlerësuar operatorin ekonomik "Lis Konstruksion" SHPK, në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.1333/2025, datë 25.09.2025. Statusi i këtij operatori ekonomik vazhdon të qëndrojë i skualifikuar, dhe këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me anë të raportit të auditit në SPE.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit "Procedurë e Hapur", me Nr. REF-49399-05-28-2025, me objekt "Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit:"Rikonstruksion objekti ekzistues i pallatit të sportit "Tamara Nikolla", Korçë" me fond limit: 249,999,211.89 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 16.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

